

VENDIM
Nr.132, datë 24.12.2014

PËRFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ANIO OIL & GAS” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, neni 14, pika 1, germa “ç”, si dhe neni 4, pika 1, germa “ç”; neni 8, neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germa “a” dhe nenin 10, të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve i Entitetit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2014, pasishqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Anio Oil & Gas sh.a.”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Anio Oil & Gas sh.a.”, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson pjesërisht kërkesat parashikuar nga ERE në nenin 9, pika 1 dhe pika 2 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe të rinovimit të licencave”, në sektorin e gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Anio Oil & Gas” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti